

Titulli i lëndës: SINTAKSË E GJUHËS TURKE 1

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Sintaksë e gjuhës turke 1
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i II-të Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	3+2
Kreditë ECTS:	7 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa 100 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Abdullah Hamiti
Të dhënat kontaktuese:	abdullah.hamiti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Sintaksë e gjuhës turke 1” është lëndë thelbësore për t’i njohur studentët me sintaksën e gjuhës turke. Do të mësohen rregullat sintaksore të gjuhës turke, rregullat për krijimin e fjalive në gjuhën turke, të dallohen gjymtyrët e fjalisë (kryefjala, kallëzuesi, objekti e plotësat) me ç’rast do të mësohen t’i përdorin drejtë gjymtyrët e fjalisë në fjalinë e gjuhës turke dhe të dijnë t’i dallojnë tipat e ndryshme të fjalive të thjeshta. Prandaj, vëmendje e veçantë i kushtohet ngjajshmërive dhe dallimeve ndërmjet sintaksës së gjuhës turke dhe të gjuhës shqipe: rendi i gjymtyrëve në fjali, tiparet e gjymtyrëve, përshtatja ndërmjet gjymtyrëve.

Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore janë që t'u ofroj studentëve njohuri për rregullat sintaksore të gjuhës turke. Sintaksa e fjalisë; që t'u mësojë grupet e fjalëve dhe përdorimin e tyre në përjasje me ato të shqipes; që t'u mësojë rregullat për krijimin e fjalive në gjuhën turke – topika e fjalisë; që t'i dallojnë dhe t'i përdorin drejtë gjymtyrët e fjalisë (kryefjalë, kallëzues, object e plotësat) në fjalinë e gjuhës turke; që të thellojnë njohuritë dhe shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën standarde turke.
--------------------	--

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptoj ndryshimin e strukturës së fjalisë në gjuhën turke dhe në atë shqipe. - të aftësohet për komunikim përkatës në situata të ndryshme. - t'i identifikojë dhe t'i verbalizojë problemet e të nxënies të sintaksës së fjalisë së gjuhës turke. - të përshkruaj situata të ndryshme jetësore duke përdorur fjalitë në gjuhën turke në mënyrë të duhur. - të aftësohet të zhvillojë biseda e të përkthej nga turqishtja në shqipe dhe anasjelltas. - Të analizojë funksionin sintaksor të togfjalëshit të gjuhës turke në përjasje me atë të gjuhës shqipe. - Të përshkruaj nominalizimin në gjuhën turke dhe në gjuhën shqipe
-----------------------------------	--

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediary	2	5	10

Konsultime me mësuesin	1	10	10
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			8
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	15	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	5	10
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			173

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi është i rregullt me formën e ligjeratave 2 orë në javë dhe poashtu përcillet me punë praktike gjatë ushtrimeve 2 orë në javë. Mësimdhënja do të mbahet duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme, duke filluar nga ato tradicionale deri te teknologjitë e reja. Prezentim, individual nga ana e studentëve me qëllim që studenti ta përvetësoj lëndën sa më mirë dhe sa më lehtë.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%. Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive 20%; Kollokfiumi 30%; Provimi final 50%.
Literatura primare:	1. Dr. sc. Abdullah Hamiti, Gramatika e gjuhës së sotme turke , Prishtinë, 2002, f. 285; 2. Prof. Dr. Leyla KARAHAN, <i>Türkçede Söz Dizimi -Cümle Tahlilleri</i> , 6. Baskı, AKÇAĞ, Ankara, 1999;
Literatura shtesë:	1. M. Metin Karaörs, <i>Türkçenin Soz Dizimi ve Cümle Tahlilleri</i> , Kayseri, 1993. 2. ATABEY, N. & Kutluk, I. & Özel, S. (1981) <i>Türkiye Türkçesinin Sözdizimi</i> , Ankara. 2. G. J. Lewis, <i>Turkish Grammar</i> , Oxford, 1967. 3. Vecihe Hatipoğlu, <i>Türkçenin Sözdizimi</i> , Ankara 1982. 4. Erguvanli, E. (1984), <i>The Ffunctionof Word Order in Turkish Grammar</i> , Los Angeles

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratorës

Java 1:	Njësitë sintaksore (Sözdizimin birlikleri) Grupet e fjalëve (Kelime grupları) - Grupi emëror (Isim tamlaması) - Grupi mbiemëror (Sıfat tamlaması) - Grupi foljor (Fiil grubu)
Java 2:	- Grupi adverbial (Zarf grubu) - Grupi postpozicional (Edat grubu) - Grupi i konjunkturëve (Bağlama grubu) - Grupi numëror (Sayı grubu).
Java 3:	Fjalìa: Karakteristikat dhe gjymtyrët e fjalisë.
Java 4:	Kallëzuesi (Yüklem)
Java 5:	Kryefjala (Özne)
Java 6:	Përshtatje e kryefjalës dhe e kallëzuesit (Özne ile yüklemnin uygunluğu)
Java 7:	Objekti (Nesne) – Akuzativi i caktuar dhe i pacaktuar – përdorimi, kuptimi dhe distinkcionet semantike.
Java 8:	Plotësit (Tümleçler): Plotësit e vendit, plotësit postpozicional dhe plotësit ndajfoljor.
Java 9:	Llojet e fjalive (Cümle çeşitleri) Fjalitë sipas ndërtimit (Yapısına göre cümleler) - Fjali të thjeshta (Basit cümle) dhe - Fjali të përbëra (Birleşik cümle)
Java 10:	Fjalitë sipas rradhitjes / sipas vendit të kallëzuesit të tyre: - Fjali të rregullta (Kurallı tümce) dhe - Fjali jo të rregullta (Devrik tümce)
Java 11:	Renditja e konstituentëve të fjalisë, me theks të veçantë në dallimet në gjuhën turke dhe shqipe.
Java 12:	Fjalitë sipas llojit të kallëzuesit: - Fjali foljore (Fiil cümlesi) dhe - Fjali emërore (Isim cümlesi)
Java 13:	Tipat e fjalive sipas llojit të kumtimit: - Fjalitë dëftore (Bildirme tümce) - Fjalitë pyetëse (Soru tümce)
Java 14:	- Fjalitë urdhërore nxitëse (Emir teşvik tümcesi) dhe - Fjalitë thirrmore - Fjalitë mohore (Olumsuz tümce)
Java 15:	Vlerësimi dhe diskutimi lidhur me detyrat në klasë dhe në shtëpi gjatë semestrit dhe përgatitja për provimin final.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Vijimi në ligjërata dhe ushtrime duhet të jetë i rregullt, gjatë mbajtjes së mësimit duhet të mbretërojë qetësia, të shkyçen telefonat celular si dhe hyrja në sallë duhet të jetë me kohë. Plagjjarizmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr note negative.